



UNIVERSITETI I PRISHTINËS,
PRISHTINË

PROJEKT-PROGRAMI I PUNËS
KANDIDIMI PËR REKTOR I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

Faton Berisha

Prishtinë, qershor 2024

I. Hyrje

Në planin global, arsimiti i lartë përgjithësisht dhe universitetet, si institucionet bartëse të tij, kanë qenë historikisht dhe janë me rëndësi të veçantë për zhvillimin e një shoqërie. Arsimiti i lartë cilësor është kusht i nevojshëm për një shoqëri me masë kritike intelektuale. Përmes krijimit të dijes dhe përmes inovacionit, mendimit kritik, nxitjes së tolerancës dhe mendjes së hapur universitetet i përgatisin qytetarët për rolin e tyre në shoqëri dhe ekonomi. Shoqëritë moderne varen nga zbatimi i dijes, shkathtësive të buta dhe shfrytëzimi i teknologjive të komunikimit dhe informacionit.

Nga ana tjetër, historia moderne e Kosovës dhe historia e Universitetit të Prishtinës janë të ndërthurura në mënyrë të pandashme ndërmjet veti. Ato e kanë kushtëzuar dhe ndikuar thelbësisht njëra tjetrën. Aktualiteti i gjerë shoqëror në Kosovë dhe zhvillimet shoqërore në të ardhmen nuk mund të interpretohen në mënyrë kuptimplote pa u vënë në kontekstin e Universitetit të Prishtinës.

Aktualisht, Kosova ka popullatën më të re në Evropë. Universiteti i Prishtinës është institucioni më i madh, elitari, i arsimit të lartë në Kosovë me rreth 30,000 studentë në 14 njësi akademike. Edhe pse problemet dhe sfidat e shumta me të cilat është ballafaquar shoqëria kosovare akoma në tranzicion i kanë ndikuar procesin mësimor, shkencor dhe, përgjithësisht, jetën akademike në të, Universiteti aktualisht rangohet si institucioni më i mirë i arsimit të lartë në hapësirën shqipfolëse dhe ndër institucionet arsimore më kredibile në rajonin e gjerë. Edhe pse në jetën akademike 55 vjet janë relativisht pak, UP-ja, përveç rolit primar si Universitet, ka pasur dhe vazhdon të ketë rol kyç në dinamikën shoqërore në Kosovë. Si asnjë institucion tjetër, këtu Universiteti ka rolin qendror në formësimin e vlerave shoqërore, nevojave dhe aspiratave të saj, duke ndikuar jetën në mënyra të shumta dhe të nduarshme.

Prandaj, kërkohet veprim dhe mendim kolektiv për t'ju përgjigjur efektivisht kësaj detyre kardinale. Në këtë kontekst – dhe më gjerë – nocione kyçe janë ato të sinergjisë dhe bashkërendimit: “Tërësia është më e madhe sesa shumta e pjesëve të saj”. Nga ana tjetër, ky mendim kolektiv është subjekt i ndryshimit dhe evoluimit të vazhdueshëm. Ecuria e përpjekjeve tona, në çdo fushë, varet nga idetë e formuara dhe të zbatuara mbi bazën e angazhimit të vazhdueshëm të komunitetit të gjerë universitar. Në këtë mënyrë, unë dua të përcjell ndjenjën time të këtij vizioni, të nxjerr në pah disa plane thelbësore në fushat kryesore për disa vitet e ardhshme. Fushat e përqendrimit parësor përfshijnë:

1. Zgjerimi i rolit ndërkombëtar të Universitetit në kuadër të Procesit të Berlinit: funksionalizimi i Qendrës për Studime të Avancuara dhe ndërtimi i infrastrukturës së studimeve të post-doktoratës.
2. Ndryshimi dhe plotësimi i Kodit të Etikës dhe rregullores procedurale të Këshillit të Etikës: konsolidimi dhe forcimi i rregullave dhe mekanizmave në lidhje me

- integritetin akademik, sjelljen personale dhe profesionale, si dhe diskriminimin dhe ngacmimin.
3. Ndryshimi dhe plotësimi i tërë infrastrukturës nënligjore dhe akteve tjera të nevojshme operacionale: domosdoshmëri imediate pas hyrjes në fuqi të Statutit të ri të Universitetit të Prishtinës.
 4. Ripërtëritja dhe fuqizimi i personelit akademik të Universitetit: implementimi i avancimeve të rëndësishme të kriterëve akademike për staf akademik pas hyrjes në fuqi të Statutit të ri të UP dhe implementimi i standardizuar i “kthimit të trurit” përmes organizimit të një procesi punësimi shumë konkurrues dhe rigoroz, mbështetur në një mekanizëm ndërkombëtar, që kërkon të tërheqë kuadrin më të talentuar me përvojë arsimore ndërkombëtare dhe aftësi dhe potencial akademik objektivisht të provuar, ose të demonstruar.
 5. Vazhdimi dhe ruajtja e përpjekjeve dhe investimeve në shkencë, duke implementuar standard ndërkombëtar të kontrollit të cilësisë së kërkimit shkencor dhe duke zhvilluar programe që financojnë projekte konkurruese në shkenca të aplikuara, teknologji dhe shkenca sociale e humanitare.
 6. Sigurimi i përvojës dhe lehtësive më të mira arsimore për studentët: riformësimi dhe rigjallërimi i kurrikulës mësimore dhe ndërlidhja e kurrikulave mësimore me tregun e punës.
 7. Vazhdimi dhe forcimi e mbështetja e mëtejme e kapaciteteve kërkimore të qendrave dhe instituteve me bazë kërkimore.
 8. Zgjerimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të stafit administrativ.
 9. Rigjallërimi i kapaciteteve institucionale për një komunikim sa më efektiv të rezultateve të stafit akademik, të arritjeve dhe kontributeve të tyre në shoqëri.
 10. Identifikimi dhe adresimi i vazhdueshëm i nevojave për burime shtesë buxhetore dhe burime të sponsorizuara, përfshirë partneritetet me biznese dhe entitete të tjera publike.
 11. Vazhdimi i digjitalizimit të të gjitha shërbimeve që ofron Universiteti.
 12. Forcimi i mëtejme i imazhit dhe i besimit publik në UP.

II. Qëllimi dhe objektivat e programit

Qëllimet kryesore të programit janë:

- Modernizimi i UP dhe vënia e tij në hap me zhvillimet aktuale në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. Kjo nënkupton vënien e UP-së në shërbim të shoqërisë dhe të ekonomisë kosovare dhe fuqizimin e mëtejme të UP-së si institucioni kryesor i arsimit të lartë në vend.
- Etabulimi i mëtejme i UP si qendër rajonale e ekselencës akademike dhe kërkimore.

Qëllimet e mësipërme korrespondojnë me fushëveprimet kryesore të programit:

- Rritja dhe diversifikimi i të hyrave, me theks të veçantë në kërkimet dhe projektet e sponsorizuara;
- Fuqizimi dhe zbatimi i autonomisë akademike;
- Ngritja e nivelit të mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- Kërkimi shkencor si pjesë integrale e arsimit të lartë;
- Fuqizimi i cilësisë dhe përmirësimi i transparencës;
- Rritja e bashkëpunimit me ekonominë dhe shoqërinë;
- Përtëritja e kuadrit cilësor mësimdhënës dhe administrativ;
- Sigurimi i infrastrukturës moderne për mësimdhënie, nxënie dhe kërkim shkencor;
- Promovimi i ndërkombëtarizimit;
- Përmirësimi i shërbimeve për studentët.

1. Zgjerimi i rolit ndërkombëtar të Universitetit në kuadër të Procesit të Berlinit

Procesi i Berlinit është një nismë bashkëpunimi ndërqeveritar e lidhur me zgjerimin e ardhshëm të Bashkimit Evropian. Filloi në 2014 me Konferencën e Berlinit, e ndjekur nga samitet pasuese në Vjenë, Paris, Trieste, Londër dhe Poznan. Pikat thelbësore janë si në vijim.

Qëllimet: Procesi i Berlinit synon të përmirësojë dhe intensifikojë integrimin rajonal në Ballkanin Perëndimor. Ai fokusohet në fusha të tilla si zhvillimi i infrastrukturës, lidhja, biznesi, shkëmbimet rajonale të të rinjve, pajtimi dhe shkenca. Në thelb, ai kërkon të përshpejtojë përafrimin e të gjithë rajonit me BE.

Pjesëmarrësit: Nisma përfshin pesë kandidatë të Ballkanit jashtë BE-së për anëtarësim në BE (Mali i Zi, Serbia, Maqedonia e Veriut, Bosnje dhe Hercegovina, Shqipëria), një kandidat potencial i Ballkanit jo-BE (Kosova) dhe disa vende anëtare të BE-së (Austri, Bullgari, Kroacia, Franca, Greqia, Gjermania, Italia, Polonia, Sllovenia). Për më tepër, Mbretëria e Bashkuar merr pjesë si vend jashtë BE-së.

Në përmbledhje, Procesi i Berlinit nxit bashkëpunimin dhe zhvillimin në Ballkanin Perëndimor, me qëllimin përfundimtar për t'i afruar këto vende me standardet dhe integrimin e BE-së.

Universiteti i Prishtinës tanimë është palë në kuadër të këtij procesi, e lidhur me format e bashkëpunimit ndërinstitutional, bashkëpunimin rajonal në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimeve shkencore, krijimit të një rrjeti të Qendrave për Studime të Avancuara në Evropën Juglindore, që do të përbëhet nga qendrat për studime të avancuara të gjashtë universiteteve të kryeqendrave të Rajonit. Këto qendra duhet të ofrojnë mbështetjen infrastrukturë për studimet post-doktorale pranë Universitetit të Prishtinës.

Akademia Kombëtare Gjermane e Shkencave “Leopoldina” shërben si koordinatore e Procesit të Berlinit për Ballkanin Perëndimor në fushën e arsimit, shkencës dhe inovacionit.

Në kontekstin global, në një kohë kur është kaq thelbësore të kuptojmë botën përreth nesh dhe të kemi të tjerët në botë që të na kuptojnë dhe njohin, Universiteti ka një rol të veçantë për të luajtur duke rekrutuar staf dhe duke përgatitur studentë, që janë në gjendje të kuptojnë dhe të përqafojnë realitetet globale në ndryshim. Universiteti duhet të sigurohet veçanërisht që stafi dhe studentët tanë të jenë në gjendje të prodhojnë dhe fitojnë dije dhe shkathtësi, që janë të krahasueshme me dijet dhe shkathtësitë e prodhuara dhe të fituara në institucione të tjera të arsimit të lartë në Evropë dhe më gjerë.

Duke pasur parasysh ndërlidhjen dhe ndërvarësinë e paparë më parë, në një pjesë të madhe të krijuar nga teknologjia moderne, si rrjedhojë një tendencë në rritje e kërkimit të njohurive në vende të tjera, ose në institucione të tjera të arsimit të lartë në Evropë dhe më gjerë, Universiteti sot përballet me një sfidë shumë më të vështirë sesa në çdo kohë më parë, që është se: në thelb nuk konkurren vetëm me institucione të ngjashme në Kosovë, apo edhe në rajon, por me universitete dhe institucione të tjera të arsimit të lartë në kontinentin më të gjerë evropian apo edhe më tej. Prandaj, ky sfond dikton nevojën për vëmendje dhe veprim shumë urgjent për të kërkuar mënyra për të artikuluar dhe zbatuar një vizion konkurrues me të tjerët në këtë horizont të zgjeruar, dhe për të tërhequr dhe mbajtur interesimin e kandidatëve më të dalluar për të zgjedhur këtë universitet për të studiuar dhe stafin më të talentuar për të punuar me ta.

Për këtë qëllim, si hap fillestar, unë planifikoj të krijoj një grup pune, në nivel të universitetit, për të rishikuar politikën dhe praktikën në lidhje me krijimin, menaxhimin dhe bashkërendimin e projekteve dhe aktiviteteve ndërkombëtare në mënyrë që të ndihmoj Universitetin të zgjerojë praninë e tij ndërkombëtare dhe të rrisë pozitën ndërkombëtare.

Një pjesë e madhe e reputacionit të sotëm përcaktohet nga mënyra se si universitetet janë renditur ndërkombëtarisht. Pavarësisht nga çdo subjektivitet dhe papërsosmëri vlerash të qenësishme në përcaktimin kuantitativ të renditjes, realiteti është se këto indekse të renditjes po ushtrojnë ndikim të rëndësishëm në perceptimin publik dhe reputacionin institucional. Një nga platformat e njohura, që gjeneron vazhdimisht vëmendjen e publikut është Renditja Webometrics e Universiteteve Botërore. Universiteti i Prishtinës kohëve të fundit është renditur edhe në platformën Times Higher Education. Këto dhe platformat e ngjashme implementojnë sisteme rangimi të mbështetur në presencën e universiteteve në Web, vizibilitetin dhe qasjen në Web. Këto sisteme rangimi masin se sa e fuqishme është prezenca e universitetit në Web me anë të Web domenit të vetë, nën-faqeve, fajlave përmbajtësorë, artikujve shkencorë etj. Me këto sisteme renditjeje në mendje, planifikoj dhe propozoj masat e mëposhtme:

- Përfshirja e çdo anëtari të personelit akademik të Universitetit në bazën akademike të të dhënave Scopus;

- Stimulimi i të gjitha njësive akademike për të publikuar aktivitetet e tyre të përditshme kërkimore në Web faqe të veçanta në anglisht në një format gjuhësor që tërheq vëmendjen e motorit të kërkimit (search-engine);
- Kërkesa për çdo njësi akademike, që të dalë dhe të aplikojë me të paktën një diplomë master në gjuhë të huaj: do të tërhiqte studentët e huaj për të zgjedhur Universitetin e Prishtinës si vend studimi;
- Të kërkoj nga çdo njësi akademike të lidhë një marrëveshje studimi të përbashkët me një njësi akademike të huaj me reputacion, dhe të sigurojë një mobilitet minimal të stafit me kolegët e tyre;
- Krijimi i një fondi për bursa për studentë dhe studiues post-doc të huaj, i cili do të paguante shpenzimet bazë të jetesës për studime dhe kërkime në programet e studimit në gjuhë të huaj në Universitetin e Prishtinës;
- Hartimi dhe krijimi i një programi ligjëruesish vizitorë për profesorët e huaj, që janë të gatshëm dhe të interesuar të ligjërojnë module në bllok në programet ekzistuese të studimit.

2. Ndryshimi dhe plotësimi i Kodit të Etikës dhe rregullores procedurale të Këshillit të Etikës

Sfida kryesore kundrejt imazhit publik që projektton Universiteti i Prishtinës tanimë 6-7 vjetët e fundit ka pushuar së qeni cilësia e kërkimit shkencor dhe e revistave ku botohen rezultatet e atij kërkimi: prezantimi i bazës akademike të të dhënave Scopus fillimisht në rregulloret për avancim të stafit në v. 2016, e deri, së fundmi, në propozimin e Statutit të ri të UP ka zgjidhur efektivisht këtë problem.

Aktualisht, sfidat kryesore kundrejt këtij imazhi janë të natyrës etike: sikur shkeljet e Kodit të Etikës të Universitetit të Prishtinës, ashtu edhe perceptimi publik në drejtim të shkeljeve të tilla.

Këshilli i Etikës i Universitetit të Prishtinës është organi përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e Kodit të Etikës të UP. Sipas këtij Kodi, Këshilli i Etikës është përgjegjës për zhvillimin e procedurave disiplinore që shoqërojnë këtë Kod, përfshirë të drejtën për të propozuar sanksionet për rastet e shkeljes së këtij Kodi.

Në kontekstin e mësipërm, do të bëj përpjekje shtesë për fuqizimin e KE si organ të pavarur dhe të kapacitetit funksional të tij. Deri më tani, vitin e shkuar, në emër të Rektoratit të UP kam përfituar një projekt Fullbright Specialist Program të Qeverisë Amerikane, sipas të cilit në periudhën maj – qershor të këtij viti në Universitet do të qëndrojë Prof. dr. Richard Hall nga Fayetteville State University, specialist në fushën e filozofisë dhe etikës, me angazhim kryekëput në mbështetjen punës së Këshillit të Etikës të UP. Korniza tanimë e aprovuar nga donatorët amerikanë e veprimtarisë së tij përfshin rishikimin e rregullores procedurale të Këshillit të

Etikës, rishikimin e Kodit të Etikës, ngritjen e kapaciteteve dhe këshillimin e KE në trajtimin e rasteve të shkeljes së Kodit të Etikës dhe identifikimin e mundësive për bashkëpunim në të ardhmen me një grup ndërkombëtar ekspertësh.

Integriteti akademik është element kyç i fuqisë dhe dinjitetit institucional të një universiteti. Pyetjet e hapura rreth integritetit të stafit të Universitetit vazhdojnë të lidhin të gjithë sjelljen e Universitetit me një markë të dobët, një ndjenjë injorance dhe një opinion të përgjithshëm negativ nga publiku i gjerë. Kjo rrëmujë duhet të pastrohet në një mënyrë që të mos dëmtojë rolin publik që bart Universiteti dhe që të sigurojë përgjigje objektive dhe të argumentuar nga vlerësimet e duhura akademike.

Për të arritur këto synime, do të ndërrojmë sa më poshtë:

- Plotësimi dhe ndryshimi i rregullores procedurale të Këshillit të Etikës dhe i Kodit të Etikës;
- Promovimi i transparencës rrënjësore dhe gjithëpërfshirjes në procesin e vlerësimit, duke përfshirë monitorimin e ngushtë dhe të vazhdueshëm nga aktivistët e shoqërisë civile;
- Krijimi i një mekanizmi të procedurës paraprake në rregulloren procedurale të Këshillit të Etikës, që ngre standardin e provës, i cili do të sigurojë që vetëm rastet e provave të vërtetuara mund të dorëzohen për vlerësim para KE;
- Provizionet që ia ngarkojnë barrën e provës palës ankuese dhe të gjitha shpenzimet për aktivizimin e mekanizmit ia ngarkojnë palës që e ka humbur rastin në rregulloren procedurale;
- Promovimi i konceptit se mbajtja e një politike të mirëfilltë etike ka pasoja financiare; megjithatë, universiteti duhet të jetë në gjendje të sigurojë këtë financim në mënyrë që të sigurojë publikun se është një lojtar i besueshëm dhe i ndershëm në tregun e arsimit të lartë.
- Çdo punim i ri që paraqitet në Universitet (veçanërisht në nivelin doktoral dhe atë master) t'i nënshtrohet një kontrolli të plagjiaturës përpara se të lejohet të kalojë në fazën e mbrojtjes. Kjo do të zbatohet njëllor për çdo publikim tjetër nga stafi dhe studentët.
- Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik duhet të kenë qasje në platformat kundër plagjiaturës dhe të bëjnë skanimin përpara se të paraqesin punën e tyre për shqyrtim për botim. Ne mund të mos jemi në gjendje të ndryshojmë historinë e asaj që ka ndodhur më parë, por sigurisht që mund të krijojmë një narrativë të re, e cila mbështetet në parimet e ndershmerisë akademike dhe shmang gabimet e së shkuarës.

Këto masa kërkojnë ndryshime të mëdha në rregullativat ekzistuese në lidhje me integritetin akademik, sjelljen personale dhe profesionale, si dhe diskriminimin dhe ngacmimin, ndryshime të cilat do të zbatohen si një çështje me prioritet të lartë dhe me transparencën dhe

gjithëpërfshirjen rrënjësore të përshkruar tashmë (çdo palë e interesuar, përfshirë aktivistët e shoqërisë civile, do të ftohen të jenë pjesë e një procesi të gjerë këshillues).

3. Ndryshimi dhe plotësimi i tërë infrastrukturës nënligjore dhe akteve tjera të nevojshme operationale

Pas hyrjes në fuqi të Statutit të ri të Universitetit të Prishtinës, propozimi i të cilit, i hartuar nga UP dhe i dorëzuar në Qeveri, pret të aprovohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nevojë imediate do të jetë ndryshimi dhe plotësimi i tërë infrastrukturës nënligjore dhe akteve tjera të nevojshme operationale, përfshirë të gjitha rregulloret e Universitetit të Prishtinës të ndikuara nga ndryshimet statutare.

Propozim-Statuti i dorëzuar nga UP për aprovim në Kuvend parasheh avancime shumë të rëndësishme të aspekteve kryesore akademike, menaxheriale dhe qeverisëse të rregulluara me Statutin e UP, brenda kornizave të Ligjit për Arsimin e Lartë. Në mesin e këtyre avancimeve të shumta, vlerësoj se më të rëndësishmet janë:

- provizionet për ngritjen e kritereve akademike për rekrutim dhe avancim të personelit akademik;
- provizionet për studimet post-doktorale;
- provizionet për “kthim të trurit”;
- provizionet për angazhim të doktorantëve në procesin mësimor;
- provizionet për procedura të lehtësuara të zotimit të mjeteve financiare nga vetëfinancimi dhe kërkimi i sponsorizuar.

Të gjitha këto, dhe shumë të tjera, kërkojnë ndryshimin dhe plotësimin e tërë infrastrukturës nënligjore dhe akteve tjera operationale të ndikuara nga ndryshimet përkatëse statutare.

Në këtë kontekst, varësisht nga procedurat e parapara me Statutin e UP, i cili, shpresoj, deri atëherë do të hyjë në fuqi, do të mbështes emërimin e komisioneve nga Këshilli Drejtues i UP dhe Senati i UP, ose do të emëroj komisionet përkatëse, të cilat do të kenë për detyrë draftimin e këtyre akteve nënligjore, për t'u propozuar dhe miratuar pastaj nga organet kompetente.

4. Ripërtëritja dhe fuqizimi i personelit akademik të Universitetit

Pas hyrjes në fuqi të Statutit të ri të UP, i cili, siç përmenda në pikën paraprake, parasheh provizionet përkatëse, do të insistoj në implementimin rigoroz të avancimeve të rëndësishme të kritereve akademike për staf akademik dhe implementimin e standardizuar i “kthimit të trurit” përmes organizimit të një procesi punësimi shumë konkurrues dhe rigoroz, mbështetur në një

mekanizëm ndërkombëtar, që kërkon të tërheqë kuadrin më të talentuar me përvojë arsimore ndërkombëtare dhe aftësi dhe potencial akademik objektivisht të provuar, ose të demonstruar.

Universiteti nuk ka asnjë investim më të rëndësishëm sesa atë për ndërtimin dhe mbështetjen e një personeli akademik të jashtëzakonshëm. Ripërtëritja e përbërjes së personelit është thelbësor për përmbushjen e aspiratave kurrikulare dhe kërkimore të Universitetit. Për ta bërë këtë, ne duhet të kemi burime dhe objektiva të qarta dhe të zbatueshme. Mbi të gjitha, ne duhet të sigurojmë që të mund të përmbushim imperativin e rekrutimit të grupit më të talentuar të studiuesve, si të rinj ashtu edhe atyre të etabluar. Në këtë mënyrë, duhet të planifikojmë një tranzicion brezash në njësitë tona akademike, në një rrethanë, kur të gjitha njësitë janë përballur dhe do të përballen me pensionime të shumta të anëtarëve të personelit akademik në vitet në vijim.

Vendimet e punësimit të personelit akademik do të kenë një ndikim të madh në Universitetin për dekadat e ardhshme. Por, ne nuk mund të shpresojmë dhe dëshirojmë të ndërtojmë një komunitet akademik të jashtëzakonshëm për gjeneratën e ardhshme pa i kushtuar vëmendje të shtuar dhe sistematike çështjeve të planifikimit, menaxhimit të burimeve dhe zhvillimit të personelit akademik. Këto përpjekje do të kërkojnë, patjetër, vëmendjen tonë sistematike dhe burime të konsiderueshme. Kjo ndërmarrje synon të mbështesë tranzicionin e gjeneratave dhe të rrisë cilësinë e personelit akademik. Përcaktimi më i saktë i numrave, duke synuar të vendosë një ekuilibër midis katërmbëdhjetë njësive të ndryshme akademike të Universitetit, do të mbështetet në një studim të plotë të të dhënave përkatëse që do të na lejojnë të kuptojmë më mirë personelin akademik të Universitetit për sa i përket numrave, përbërjes dhe nivelin e mbështetjes që nevojitet për avancimin akademik të secilës njësi akademike.

Objektiv yni i rëndësishëm duhet të jetë rrënjosja e një ndjenje besimi shoqëror në procesin e punësimit. Në zbatim të këtij objekti dhe për të tërhequr kuadrin më të talentuar të kandidatëve me përvojë arsimore ndërkombëtare dhe aftësi dhe potencial akademik të provuar, ose objektivisht të dëshmuar, unë propozoj një proces punësimi shumë konkurrues dhe rigoroz, duke përfshirë një mekanizëm ndërkombëtar të modeluar në mënyrë të përshtatshme. Vlerësimi i aplikimeve dhe rekomandimeve do të bëhet nga komisione të përbëra nga studiues dhe profesorë me reputacion ndërkombëtar. Kjo do të ruajë kompetencat formale vendimmarrëse të organeve të Universitetit, në radhë të parë atë të Senatit, por që njëkohësisht do të lejojë krijimin e komisioneve të përbëra me përfshirjen e profesorëve të jashtëm në mënyrë që të vlerësojë objektivisht meritat e secilit kandidat. Një gjë e tillë do të zvogëlojë diskrecionin lokal duke parandaluar kështu procesin nga kontestimet e legjitimitetit që shpesh shoqërojnë rekrutimet e reja. Një nismë e tillë gjithashtu do të nisë një praktikë të re, bashkëkohore, të rekrutimit akademik, që mbështetet në standardet më të larta të bazuara në merita, e cila insiston në njerëz që kanë kredite në kërkimin dhe arsimin ndërkombëtar dhe që janë të aftë të provojnë veten si kandidatë të përshtatshëm për poste akademike ose profesoriale përpara një jurie, anëtarët e së cilës janë profesorë të rregullt me kredibilitet të dëshmuar universitetet më të mira botërore.

Objektivi ynë përfundimtar duhet të jetë ekselencia akademike dhe vendosja e një standardi të lartë në fushat vendimtare të përsosmërisë akademike dhe pozitës ndërkombëtare të Universitetit.

Në terma praktikë të menaxhimit lidhur me operacionalizimin e punës së personelit ekzistues akademik, planifikoj:

- Të synoj shkrirjen graduale të kufirit ndërmjet orëve të ligjëratave dhe atyre të ushtrimeve. Ndarja e tillë e orëve të leksioneve është karakteristikë ekskluzive e universiteteve të Evropës Lindore, e trashëguar nga kohët tanimë të shkuara;
- Të synoj zvogëlimin gradual të personelit akademik në thirrjen e Asistentit mësimor duke zvogëluar numrin e rekrutimeve të personelit akademik në këtë thirrje mësimore dhe duke promovuar kalimin, gjithnjë në baza meritore, të personelit ekzistues në këtë thirrje në thirrjen Profesor asistent;
- Angazhimin e doktorantëve në procesin mësimor.

5. Vazhdimi dhe ruajtja e përpjekjeve dhe investimeve në shkencë

Lidhja integrale ndërmjet mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit shkencor në arsimin e lartë është qenësore dhe veti dalluese e universiteteve moderne.

Zhvillimi i hulumtimit shkencor dhe krijimtaria artistike në Universitetin e Prishtinës ishin sporadike, individuale, pa mbështetje institucionale dhe jo-uniforme në njësitë akademike. Në periudhën 2003-2013 vetëm 826 punime shkencore të autorëve kosovarë ishin indeksuar në bazën akademike me kredibilitet botëror: Scopus, duke qenë, kështu, atëbotë të fundit në Rajon.

Që nga ajo kohë, Universiteti i Prishtinës ka pasur ngritje të hovshme të kualitetit të publikimeve shkencore të stafit akademik dhe doktorantëve të vetë. Avancim fundamental është arritur në menaxhimin e kontrollit të kualitetit të kërkimit shkencor. Në këtë kontekst, premisa bazë ka qenë se kualiteti i një kërkimi shkencor përcaktohet nga kredibiliteti akademik ndërkombëtar i revistave shkencore në të cilat publikohen rezultatet e kërkimit. Si indikator kredibiliteti i një reviste shkencore konsiderohet rangimi i revistës në bazën akademike të të dhënave Scopus. Qasja e tillë është sanksionuar ligjërisht në rregulloret përkatës të UP dhe është zbatuar rigorozisht në nivel Senati në procedurat e avancimit të stafit akademik dhe të verifikimit të punimeve të doktoratës të doktorantëve të UP.

Ndërkaq, qasja e tillë ka rezultuar me përmirësimin e imazhit të projektuar nga Universiteti në opinionin publik dhe në ngritjen e ndjeshme të rangimit të UP në listat relevante ndërkombëtare.

Falë potencialit akademik dhe përpjekjeve imagjinative të shumë anëtarëve të personelit akademik, Universiteti sot pozicionohet gjithnjë e më mirë për të ecur përpara në një kohë mundësish të jashtëzakonshme në shkenca. Mbështetur në këtë potencial Universiteti ka çdo

arsye për të aspiruar lart dhe për të prodhuar studiues shumë kompetentë dhe konkurrues ndërkombëtarisht.

Shkenca është e shtrenjtë, por është jashtëzakonisht e rëndësishme. Investimet aktuale kanë filluar të vlerësojnë këtë rëndësi. Në nivel kombëtar, sipas ligjit fondet e alokuara për kërkime shkencore janë 0.7% e GDP (prodhimi i brendshëm bruto). Por, është thelbësore të vërehet se fondet aktuale të alokuara mund të jenë më të vogla sesa ky cak. Kosova synon të integrohet në Bashkimin Hapësirën Kërkimore Evropiane (European Research Area), dhe investimi i vazhdueshëm në infrastrukturën kërkimore luan rol vendimtar në arritjen e këtij qëllimi. Ndërkaq, në krahasim me atë të v. 2022, që ishte vetëm 0.1% e GDP, kjo shifër pasqyron angazhimin e vendit për kërkim shkencor dhe zhvillim. Është thelbësore të vazhdohet me nxitjen e rritjes në këto fusha për të nxitur përparimin dhe avancimin ekonomik.

Situatë analoge, megjithëse në terma relativ dukshëm më e mirë është edhe në Universitetin e Prishtinës, si institucion bartës i kërkimit shkencor në vend. Deri në v. 2022 strategjia e Universitetit parashikonte ndarjen e vetëm 1% të buxhetit për kërkime shkencore. Si vetvetiu e pakconceptueshme dhe e papranueshme, kjo shifër është rritur ndjeshëm gjatë dy viteve të fundit.

Unë synoj të propozoj që ky trend i rritjes së buxhetit të Universitetit të alokuar për kërkimin dhe inovacionin të mbahet. Do të bëj çdo përpjekje për të bindur Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit që të zotojë, nga burimet e veta, shumë të ngjashme procentuale në zbatimin e nismave të përbashkëta që do të mbështesin kërkimin shkencor, do të rrisin rezultatet e kërkimit, do të prodhojnë njohuri të rëndësishme për kurrikulat mësimore dhe nevojat e tregut dhe, në përgjithësi, të zgjerojnë kufijtë e pozicionit tonë akademik.

Një praktikë e mirë në këtë drejtim, që tanimë implementohet në UP, është angazhimi i studentëve të doktoratës për punë kërkimore. Krahas kësaj e në pajtim me provizionet në Statutin e ri, doktorantët do të angazhoheshin edhe për mbajtjen e orëve mësimore (që, sërish, ofron mundësi për punë cilësore me kosto relativisht të lirë).

Në zbatim të objektivës së rritjes së buxhetit për kërkime, unë propozoj masat e mëposhtme:

- Rritjen e buxhetit të Universitetit të alokuar për kërkimin dhe inovacionin në jo më pak se 10% e buxhetit të tij të përgjithshëm.
- Rritjen e numrit të projekteve kërkimore të financuara nga Universiteti. Do të synohet një kombinim i projekteve kërkimore themelore dhe të aplikuara.
- Sigurimi i fondeve për një numër projektesh të një natyre ndërdisiplinore, përkatësisht projekte që kalojnë kufijtë tradicionalë disiplinorë në kërkim të sfidave të reja intelektuale për një shumë prej rreth 50,000 Euro për projekt – preferencë do t'u jepet projekteve që shquhen nga ndërveprimi produktiv i kërkimit shkencor dhe inovacionit teknologjik.

- Ruajtja e praktikës së ndarjes së mjeteve për organizimin e një konference vjetore akademike ndërkombëtare, ose ngjarje të ngjashme, nga secila prej njësive akademike, me pjesëmarrje të konsiderueshme të studiuesve dhe profesorëve ndërkombëtarë (të paktën gjysma e panelit), e që do të rezultonte në publikimin e një përmbledhjeje të punimeve të konferencës dhe/ose shpërndarje më të gjerë të rezultateve nëpërmjet mjeteve të tjera.
- Ruajtja e praktikës ekzistuese të financimit të atyre autorëve që botojnë në revista të indeksuara në Scopus, kuartilat Q1 dhe Q2, me synimin për të rritur si vlerën e caktuar për artikujt, ashtu edhe numrin e artikujve që do të financohen në vit.
- Njohja e studiuesve nga Universiteti me numrin më të madh të citimeve që do të rezultonte me një procedurë të lehtësuar për promovimin akademik brenda Universitetit dhe me më shumë mundësi për kërkime përmes mobilitetit në universitetet më të mira botërore.
- Do të synoj të planifikoj financim për qasje në bibliotekat/bazat e të dhënave digjitale të përgjithshme dhe të specializuara dhe të financoj blerjen e një numri të caktuar librash dhe abonimin në revistat kryesore akademike për njësi akademike, të përzgjedhura nga anëtarët e komunitetit akademik përkatës.
- Kycja në mësimdhënie të studentëve e doktoratës, me qëllim afrimin e tyre me Universitetin, stimulimin e kërkimit shkencor në mesin e tyre, ndërtimin e kapaciteteve kërkimore për të ardhmen dhe për të rritur rezultatet e kërkimit të Universitetit.
- Promovimi i një kulture respekti dhe nderimi për ata që janë shquar me rezultate dhe kontribute eminente shkencore në disiplinat e tyre.
- Zhvillimi i marrëdhënieve të ngushta bashkëpunuese me partnerët ndërkombëtarë për të siguruar mundësi shtesë financimi, ose për të ndjekur përpjekje të përbashkëta që kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve tona kërkimore, duke përfshirë veçanërisht rritjen e pjesëmarrjes dhe të projekteve fituese në programin Horizon Europe.
- Ndërtimi i partneriteteve me nisma dhe ndërmarrje private dhe në këtë proces të stimuloj investimet nga sektori privat.
- Zhvillimi i një Strategjie të Specializimit të Zgjuar.
- Identifikimi i sfidës së rreshtimit në të ardhmen karshi kërkesave të shkencës së hapur (open science) në hapësirat akademike europiane dhe diskutimi i qasjeve për adresim të saj.

Si përfundim, Universiteti ka potencial të ngritjes së mëtejme të ekselencës në kërkim shkencor duke implementuar standard ndërkombëtar të kontrollit të cilëprasisë së kërkimit shkencor dhe duke zhvilluar programe që financojnë projekte konkurruese në shkenca të aplikuara, teknologji dhe shkenca sociale e humanitare.

6. Sigurimi i përvojës dhe lehtësive më të mira arsimore për studentët

Njëra nga sfidat më të mëdha të Universitetit është t'u ofrojë studentëve tanë mundësinë për një përvojë arsimore në përputhje me talentet dhe aspiratat e tyre të jashtëzakonshme. Për ta arritur këtë, ne duhet të ndjekim dhe zbatojmë trendet imperative në Evropën Perëndimore dhe Amerikën e Veriut karshi shërbimeve të studentëve.

Fuqizimi i implementimit të punës praktike në nivel të kurrikulave mësimore është hap i rëndësishëm drejt lidhjes së procesit mësimor me tregun e punës dhe industrinë. Universiteti duhet të rrisë edhe kërkesat vetanake për punë praktike të studentëve, që njëkohësisht do të adresonte edhe mungesat në personel të rregullt administrativ.

Duhet, poashtu, të intensifikohet bashkëpunimi ndërmjet Qendrës së Zhvillimit të Karrierës së UP dhe kompanive lidhur me begatimin e javës së prezantimit të bizneseve. Interesimi i kompanive mbi programet e ofruara në UP dhe spektri i këtij interesimi duhet të përdoren si indikatorë për modernizimin e kurrikulave mësimore në drejtim të ofrimit me tregun e punës.

Qendra e UP e ndërmarrësisë, VentureUP, ka bërë punë të mirë gjatë viteve të fundit në kontekstin e ofrimit të alternativave ekstrakurrikulare për studentët. E themeluar si rezultat i një projekti të financuar nga Qeveria e SHBA, VentureUP ka arritur të përfitojë nga fonde të BE për të përfunduar disa cikle inkubimi të start-up-ëve të ndërmarrë nga studentë të UP.

Në lidhje me këto, unë do të përshkruaj vetëm disa tendenca të gjera:

- Përpjekjet për rishikimin dhe reformën kurrikulare duhet të jenë të vazhdueshme. Çdo njësi akademike do të jetë e detyruar të angazhohet me vlerësues të huaj në çdo rishikim kurrikular të paktën në nivelin bachelor.
- Shumë nga njësitë tona akademike duhet të krijojnë qasje të reja për profesionet dhe sektorët e shoqërisë ku ata ndikojnë dhe u shërbejnë, duke kombinuar rigorozitetin e studimit me rëndësinë e praktikës. Unë do të stimuloj dhe së bashku me Ministrinë e Arsimit do t'i japë përparësi fushave të studimit që dalin nga tregu.
- Brenda Universitetit, duhet të fillojmë të rrisim bashkëpunimin në njësi dhe departamente të ndryshme akademike. Programet e përbashkëta të diplomave gjithnjë e më shumë i lejojnë studentët të përgatiten për karrierë, ose mundësi punësimi që sjellin interesime të ndryshme profesionale dhe intelektuale për të përballuar disa nga problemet më urgjente të shoqërisë.
- Vlerësimi i studentëve duhet të jetë ekskluzivisht vlerësim permanent, e jo vlerësim i mbështetur në iterimin e afateve të provimeve.
- Përvoja arsimore e studentëve tanë duhet të shtrihet gjithnjë e më shumë përtej kufijve të Universitetit tonë. Ne do të ndjekim nisma dhe marrëveshje bashkëpunimi ndërkombëtar që promovojnë përvojën ndërkombëtare të studentëve tanë. Do të bëj të

gjitha përpjekjet për të rritur numrin e studentëve, që studiojnë jashtë vendit, si pjesë e programeve të shkëmbimeve ndërkombëtare.

- Jeta ekstra-kurrikulare duhet të vazhdojë të zhvillohet, duke ndjekur projekte bashkëpunuese, që do të rezultojnë në krijimin e hapësirave tërheqëse studentore të mbështetura nga Universiteti. Nisma të tilla do të hulumtohen me përfshirjen e udhëheqjes dhe anëtarëve të stafit të Fakultetit të Arteve dhe Fakultetit të Arkitekturës.
- Studentët duhet të kenë qasje të duhur dhe të mjaftueshme në teknologjinë bashkëkohore.

7. Vazhdimi dhe forcimi e mbështetja e mëtejme e kapaciteteve kërkimore të qendrave dhe instituteve me bazë kërkimore.

Qendrat e specializuara të përqendruara në kërkime të sponsorizuara duhet të jenë komponentët kryesorë të ndërmarrjes kërkimore të Universitetit. Ato janë të pozicionuara veçanërisht mirë për të bashkërenduar përpjekjet dhe projektet kërkimore brenda çdo njësie akademike të Universitetit. Si pjesë e këtij objekti, përqendrimi do të jetë kryesisht në detyrat e mëposhtme:

- Do të kërkoj të mbështes qendrat dhe institutet ekzistuese.
- Do të siguroj që të implementohen provizionet e Statutit të ri dhe rregulloret shoqëruese për të hequr strukturën ekzistuese burokratike në lidhje me projektet e donatorëve të huaj të Universitetit.
- Do të kërkoj heqjen e dispozitës aktuale në rregulloren përkatëse që parashikon një përqindje relativisht të lartë të të ardhurave nga këto qendra apo institute kërkimore që do t'i alokohen buxhetit të Universitetit.
- Do të kërkoj mënyra për të përmirësuar dhe thjeshtuar procedurën e administrimit të fondeve nga këto qendra apo institute kërkimore, në mënyrë që të ulet barra administrative për funksionimin e tyre.

8. Zgjerimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të stafit administrativ

Administrata e mirë shtetërore është njëri nga tiparet kryesorë të zhvillimit dhe stabilitetit të një vendi.

Në analogji të plotë, një administratë kompetente dhe efektive është jetike për funksionimin dhe suksesin e çdo institucioni në përgjithësi. E njëjta gjë është edhe me Universitetin e Prishtinës. Me gjithë përpjekjet dhe angazhimin e stafit aktual administrativ, mund të vërehet mungesë kronike e rekrutimit transparent dhe efikas të personelit efektiv të ri për një periudhë tanimë të gjatë kohore. Sipas të dhënave në dispozicion administrata e Universitetit është e nën-populluar rëndë.

Zbatimi i shumë projekteve dhe nismave, veçanërisht atyre me karakter ndërkombëtar, do të kërkonte personel administrativ të përgatitur mirë, të pajisur me gjuhë të huaj dhe shkathtësi të buta. Ndërsa, procesi i punësimit të personelit administrativ i nënshtrohet një trupi tjetër legjislativ, kriteret e meritës dhe ekselencës duhet të zbatohen njëjloj për këtë kategori personeli sikur për personelin akademik.

9. Rigjallërimi i kapaciteteve institucionale për një komunikim sa më efektiv të rezultateve të stafit akademik, të arritjeve dhe kontributeve të tyre në shoqëri

Në kohën e sotme, komunikimi efektiv i një rezultati dhe publiciteti shpesh e tejkalon edhe vetë rezultatin. Kështu, ndërsa objektivi kryesor i agjendës duhet të përqendrohet rreth rezultateve, arritjeve dhe kontributeve të personelit akademik, njohja e këtyre rezultateve nuk është vetëm intelektualisht e dëshirueshme, por edhe e nevojshme për të maksimizuar ndikimin arsimor dhe kërkimor të Universitetit dhe kontributin e përgjithshëm shoqëror. Fatkeqësisht, shpesh, arritje apo kontribute të personelit, i nënshtrohen heshtjes publike. Faqet e Internetit e Universitetit dhe të njësive akademike individuale duhet të jenë pikënisja bazë për zbatimin e një vizioni të një hapësire më të hapur, aktive dhe më të fuqishme për transmetimin e të gjitha aktiviteteve dhe rezultateve të personelit akademik dhe studentëve, duke shkuar kështu përtej thjesht publikimit të mbledhjeve dhe takimeve administrative apo zyrtare të udhëheqjes së Universitetit dhe asaj të njësive akademike. Çdo publikim i personelit akademik, ashtu si çdo kontribut tjetër, kombëtar apo ndërkombëtar, duhet të përcillet publikisht në shërbim jo vetëm të transparencës, por edhe të njohjes institucionale dhe reputacionit publik. Në përputhje me synimet dhe tendencat ndërkombëtare, çdo lajm i tillë duhet të publikohet edhe në versionin e faqeve të Internetit në gjuhën angleze. Një prani e shtuar në platformat e mediave sociale është gjithashtu e rëndësishme. Për të zbatuar këtë vizion, është i domosdoshëm një pozicion i përhershëm i Drejtorit të Komunikimit dhe/ose profesionistëve shumë të aftë të medias. Poashtu është i nevojshëm hulumtimi i perceptimit të Universitetit në media informative, faqe e portale Interneti dhe media sociale.

10. Identifikimi dhe adresimi i vazhdueshëm i nevojave për burime shtesë buxhetore dhe burime të sponsorizuara, përfshirë partneritetet me biznese dhe entitete të tjera publike.

Është e vetëkuptueshme që arsimit i lartë, si investimi kryesor i një shoqërie në të ardhmen e vetë, nuk do të ketë as mundësinë më të vogël për përmbushjen e misionit të vetë pa mbështetjen adekuate financiare të shoqërisë. Në rastin e Universitetit të Prishtinës, si institucion publik bartës i arsimit të lartë në vend, kjo mbështetje përkthehet në terma praktik në alokimin e buxhetit adekuat. Mendoj se një krahasim i thjeshtë, i përafëruar dhe provizor i buxheteve të alokuara me dy institucione rajonale me aspirata analoge me Universitetin e Prishtinës në hapësirat përkatëse kombëtare flet shumë mbi adekuatshmërinë e buxhetit të alokuar aktualisht.

Universiteti i Lublanës, me numër të përafërt studentësh sikur UP, ka në dispozicion dhjetëfishin e buxhetit për një student krahasuar me UP. Universiteti i Beogradit, me trefishin e numrit të studentëve, disponon me trefishin e buxhetit për një student krahasuar me UP.

Do të bëj çdo përpjekje që Këshilli Drejtues i UP e shoh të arsyeshme për të bindur Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit që të alokojë buxhet adekuat dhe të arsyeshëm, të nevojshëm për t'i mundësuar Universitetit plotësimin e obligimeve të veta karshi shoqërisë kosovare.

Duke pasur parasysh shkallën e ambicieve tona legjitime, është e natyrshme të identifikojmë dhe të kërkojmë burime që plotësojnë ato të Universitetit. Për të vazhduar me tendencat e një universiteti modern dhe për të qenë në gjendje të lidhë funksionet dhe veprimet e tij sa më afër që të jetë e mundur me nevojat dhe mundësitë e tregut, Universiteti duhet të eksplorojë në mënyrë aktive dhe të krijojë partneritete me një mori entitetesh të tjera, publike dhe private. Një grup i përzier këshillues në nivel të Rektoratit, i përbërë nga pjesëtarë të vullnetshëm për të kontribuar të personelit akademik, të komunitetit të biznesit dhe, përgjithësisht, intelektualë të shquar vendorë e ndërkombëtarë, mund të krijohet fillimisht për të kërkuar mënyra për të eksploruar dhe mobilizuar potencialin publiko-privat në fushën e arsimit të lartë, kërkimit dhe inovacionit. Padyshim që mund të imagjinohen shumë forma, që mund të marrin partneritete të tilla, nga financimi i kërkimeve specifike të tregut, deri te pyetjet e stilit arkitektonik dhe jetës në kampus.

Në përgjithësi, duhet të ketë një korrelacion midis prioriteteve strategjike dhe objektivave specifike për mbledhjen e fondeve.

Problematikë në vete paraqet shuma e buxhetit e alokuar për paga të personelit akademik. Krahas angazhimit të personelit akademik të jashtëm, në të ardhmen në këtë drejtim duhet mundësuar anagazhimin e doktorantëve në procesin mësimor, që, sërish, ofron mundësi për përpjekje akademike cilësore me kosto relativisht të lirë.

Nga ana tjetër, objektivë e menjëhershme duhet të jetë sigurimi i fondeve për sanimin e infrastrukturës fizike: renovimin, rregullimin dhe zgjerimin e nevojshëm të objekteve të dëmtuara ose amortizuara në kampusin universitar.

11. Vazhdimi i digjitalizimit të të gjitha shërbimeve që ofron Universiteti.

Funksionalizimi praktik i digjitalizimit të shërbimeve tanimë është një nga pikat e forta të Universitetit të Prishtinës. Nga ana tjetër, Universiteti mund të jetë i ekspozuar ndaj kërcënimeve të natyrës së teknologjisë informative për shkak të mbulueshmërisë së pamjaftueshme në aspektin e dokumentacioneve teknike dhe legjislativë të cilat garantojnë pacenueshmërinë e Universitetit karshi vazhdimësisë së këtyre shërbimeve.

Universiteti ka Web platformën, tanimë të standardizuar SEMS, e cila, ndërmjet tjerash, zbatohet si sistem për menaxhim të vlerësimit të studentëve dhe sistem për menaxhim të përmbajtjes mësimore.

Në terma më praktikë, do të synoj:

- Plotësimin e dokumentacionit teknik dhe legjislativ karshi shërbimeve të digjitalizimit.
- Shtimin e një moduli i cili siguron ngritjen e njohurive dhe ndjeshmërisë së personelit akademik karshi ngacmimeve dhe ngacmimeve seksuale, me qëllim parandalimi dhe përmirësimi të perceptimit publik.
- Shtimin e një moduli i cili siguron qasje për tërë personelin akademik dhe të gjithë studentët në një softuer “state of the art” për parandalim të plagjiaturës në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.
- Shtimin e një paneli të dhënash (“data board”) në Web faqen e Universitetit të Prishtinës për publikimin e të dhënave të natyrës agregate mbi Universitetin.

12. Forcimi i mëtejme i imazhit dhe i besimit publik në UP.

Sfidat e para mëse një dekade të Universitetit karshi imazhit dhe besimit publik në UP lidheshin kryesisht me kualitetin e publikimeve shkencore të personelit akademik. Në ndërkohë, qasja vlerësimit të kualitetit të këtyre publikimeve përmes prezantimit të bazës akademike të të dhënave Scopus në rregullativën ligjore të Universitetit dhe zbatimi rigoroz i saj në nivel të Senatit të UP ka rezultuar me përmirësimin e imazhit të projektuar nga Universiteti në opinionin publik dhe në ngritjen e ndjeshme të rangimit të UP në listat relevante ndërkombëtare.

Sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet Universiteti sot karshi imazhit dhe besimit publik në UP janë të natyrës etike. Aktualisht Këshilli i Etikës i Universitetit të Prishtinës është i tejngarkuar me një mori rastesh denoncimesh kundër pjesëtarëve të personelit akademik për shkelje të Kodit të Etikës. Disa nga këto, madje janë eksploatuar deri në keqpërdorim nga pjesëtarë mediash të ndryshme. Një gjë e tillë i kontribuon formësimit të një perceptimi publik negativ karshi Universitetit të Prishtinës.

Universiteti i Prishtinës duhet të jetë tërësisht i përkushtuar për të ruajtur një mjedis akademik të sigurt dhe gjithëpërfshirës, ku i gjithë personeli akademik, të gjithë studentët dhe i tërë personeli administrativ gjen ambient të përshtatshëm për performimin e të gjitha detyrave të tyre karshi procesit mësimor, hulumtimeve shkencore dhe shërbimeve tjera, në pajtim me të drejtat dhe përgjegjësitë përkatëse. Universiteti duhet të jetë i vendosur që të ndërmerren masa të nevojshme për të garantuar këtë mjedis të sigurt dhe të ndershëm akademik.

Në kontekstin e mësipërm, po e formuloj këtu në terma të përgjithshëm mendimin tim se është detyrë e menjëhershme që të adresohen çështjet vijuese:

- Të fuqizohet Këshilli i Etikës i Universitetit të Prishtinës për të përmbushur detyrën parësore të tij si organ më i lartë vendimmarrës i Universitetit mbi shkeljet etike: marrjen e vendimeve meritore.
- Të parandalohen shkeljet etike duke njoftuar dhe vetëdijësuar personelin akademik mbi problematikën e shkeljeve etike: do të synoj që modulet edukative rreth kësaj problematike të bëhen pjesë e platformës digjitale të Universitetit e obligueshme për t'u vijuar nga personeli akademik dhe të bëhen pjesë e moduleve trajnuese për personelin universitar të ofruara nga Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie.
- Të ketë një hulumtim të opinionit publik në drejtim të disenjimit të një narrative objektive të vetë Universitetit me qëllim korrigjimi të perceptimit publik karshi UP.

Referencat

1. Q. Qerimi, *Një plan për Universitetin (Koncept pune)*, Dokument i brendshëm i UP (2022).
2. F. Berisha, *Projekt-programi i punës – Kandidimi për rektor të UP*, Dokument i brendshëm i UP (2020).
3. Universiteti i Prishtinës, *UP-ja dhe Akademia Kombëtare Gjermane e Shkencave diskutojnë për format e bashkëpunimit në kuadër të Procesit të Berlinit*, <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,35,2863> (qasur më 3 qershor 2024).
4. Wikipedia contributors, *Berlin Process*, Wikipedia, The Free Encyclopedia, 12 April 2024, 12:36 UTC, https://en.wikipedia.org/w/index.php?title=Berlin_Process&oldid=1218558302 (qasur më 3 qershor 2024).
5. The Berlin Process, *The Berlin Process - 2022*, <https://www.berlinprocess.de/en/the-berlin-process-2022> (qasur më 3 qershor 2024).
6. Universiteti i Prishtinës, *UP-ja mban punëtorinë "Këshilli i Etikës përballë sfidave të marrjes së vendimeve meritore"*, <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,37,2898> (qasur më 4 qershor 2024).
7. Universiteti i Prishtinës, *Lajmet dhe komunikatat për publikun*, <https://uni-pr.edu> (2023, 2024).
8. Microsoft Copilot, *Retrieved from OpenAI ChatGPT* (2024).
9. Universiteti i Prishtinës, *Propozimi i Statutit të Universitetit të Prishtinës (UP) Hasan Prishtina* (2023).
10. Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Statuti i Universitetit të Prishtinës* (2013).